



raporti i **MONITORIMIT**

PËR PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

Raporti numër 2

(periudha e raportimit:
tetor 2018 - janar 2019)

Projekti:

Aksion për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet më të madh të Këshillit Gjyqësor të RM

Implementues:

Instituti për të Drejtat e Njeriut



Ky publikim u përgatit në kuadër të projektit "Aksion për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet më të madh të Këshillit Gjyqësor të RM", i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetje të Ambasadës Britanike në Shkup. Opinionet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë çdoherë opinionet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.

Hyrje

Raporti i monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor të RM, në periudhën kohore nga muaji tetor 2018 deri në janar të vitit 2019, është hartuar në kuadër të projektit *“Aksion për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet më të madh të Këshillit Gjyqësor të RM”*, për matjen e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (KGJRM).

Instituti për të Drejtat e Njeriut ka për qëllim në mënyrë më të lehtë dhe gjithëpërfshirëse ta vlerësoj transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e punës së Këshillit Gjyqësor, përmes prezencën në mbledhjet publike, monitorimit të ueb faqes të Këshillit Gjyqësor dhe përmes qasjes së lirë në informacionet me karakter publik.

Ndryshime në ligjin për Këshillin Gjyqësor

Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata dhe Propozim – ligji i ri për Këshillin Gjyqësor të R.M.² janë dërguar deri te Kuvendi i RM. Teksti i publikuar në faqen e ENER³ ishte Propozim-Ligj për ndryshime dhe plotësime të ligjit për Këshillin Gjyqësor, ndërsa deri te Kuvendi i RM u dërgua Propozim-Ligj i ri për Këshillin Gjyqësor të RM. Edhe pse në ndërkohë u mbajtën debate me ekspertë për propozim ndryshimet e Ligjit për gjykata dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor, ministria kompetente nuk na njoftoi për ndryshimet dhe tekstin përfundimtar i cili iu dorëzua Kuvendit.

Në ndërkohë, Komisioni i Venecias miratoi opinione për Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për Gjykata.⁴

Në këtë opinion theksohet se në të ardhmen do të ishte e dobishme të sqarohen çështjet të cilat janë rregulluar me Ligjin për gjykata dhe ato që janë rregulluar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RM, me qëllim që të shmanget paralelizmi dhe mbivendosja midis dy ligjeve. Në mënyrë plotësuese komente konkrete janë dhënë për dispozitat të cilat kanë të bëjnë me: zgjedhjen e gjyqtarëve (neni 45 dhe 46), zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave (neni 47), transferimi dhe sistematizimi i përkohshëm i gjyqtarëve (neni 39 dhe 40), ndërprerja e funksionit të gjyqtarit (neni 73), masa më të lehta dhe më të rënda disiplinore (nenet 74-78) dhe largimi nga funksioni i gjyqtarit gjatë kohës së procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë (neni 67).

Nga opinioni mund të shihet se rekomandimet (opinionet) e dhëna nga Instituti për të Drejtat e Njeriut sa i përket procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave janë inkorporuar në të njëjtin.

1 <http://www.ihr.org.mk/project.php?pid=357>

2 Komisioni i Venecias miratoi Opinion për Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për Gjykata. Në Opinion theksohet se do të ishte e dobishme që në të ardhmen të sqarohen çështjet të cilat janë rregulluar me Ligjin për gjykata dhe ato të cilat janë rregulluar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RM, me qëllim që të shmanget paralelizmi dhe mbivendosja midis dy ligjeve. Në mënyrë plotësuese komentet konkrete janë dhënë për dispozitat që kanë të bëjnë me: zgjedhjen e gjyqtarëve (nenet 45 dhe 46), zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave (neni 47), transferimin e përkohshëm dhe sistematizimin e gjyqtarëve (neni 39 dhe 40), ndërprerjen e funksionit të gjyqtarit (neni 73).

3 Regjistri unik elektronik nacional i akteve normative - RUEN – (EHEP), <https://ener.gov.mk/>

4 Në Seancën e 116-të plenare të Komisionit të Venecias të mbajtur më datë 19-të dhe 20-të tetor u miratua Opinioni nr. 927/2018 (CDL-AD(2018)022) për Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për gjykata. Nga Opinioni i bashkëlidhur mund të shihet se reagimet (opinionet) e dhëna nga Instituti për të Drejtat e Njeriut lidhur me procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave janë inkorporuar në të njëjtin. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)022-e)

TRANSPARENCA E KGJRM

Transparenca përmes mbledhjeve të hapura të KGJRM

| | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Janar |
|----------------------|-------|--------|--|-------|
| Mbledhje të hapura | 4 | 3 | 3 | 1 |
| Mbledhje të mbyllura | / | / | 2 pika të rendit të ditës - jo publike | / |

Llojet e publikimeve

| Lloji i publikimit | Në kohë | Të plota | Shënim |
|----------------------|--------------------|---------------------|--|
| Komunikatë | Në kohë | Pjesërisht të plota | <p>Komunikatat për mbledhjet e mbajtura janë titulluar si “Komunikatë për mbledhje...” ose “Komunikatë nga mbledhja...” me numrin e mbledhjes. Theksohen vetëm pikat e miratuara nga rendi i ditës, pa pasur arsytim.</p> <p>Komunikata për publikun për mbledhjen në të cilën u konfirmua lista e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor për herë të parë përmbante informacione më të detajuara me listën e kandidatëve.</p> <p>Komunikatat e tjera janë titulluar si: “Komunikatë”. Në përgjithësi, Komunikatat kanë të bëjnë me vizitat dhe takimet të cilat anëtarët e Këshillit Gjyqësor i kanë mbajtur si dhe komunikatat me informacione për media.</p> |
| Vendime | Pjesërisht në kohë | Të plota | Në këtë periudhë janë publikuar vetëm vendimet për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave. Megjithatë, vendimet për zgjedhje tani janë më përmbajtjesore dhe përmbajnë informacione për të gjithë kandidatët e paraqitur. |
| Procesverbale | Pjesërisht në kohë | Të plota | <p>Publikimi i procesverbaleve në aspektin kohor ndërlidhet me miratimin e mbledhjes së KGJRM, ndërsa kjo mund të ndodh edhe pas disa javësh nga mbledhja për të cilën ka të bëjë procesverbali.</p> <p>Deri më tani, për pikat të cilat janë të mbyllura për publikun, votimi në këtë pjesë nuk është publikuar në procesverbale.</p> |
| Raporte | Në kohë | Pjesërisht | Raportet tremujore për punën e gjykatave, si dhe Raporti vjetor i KGJRM publikohen me rregull. Megjithatë, nuk publikohen lloje të tjera të raporteve, e as të dhënat statistikore ose analizat. |
| Konkluzione | Në kohë | Pjesërisht | Për herë të parë është publikuar konkluzioni me të cilin njoftohen qytetarët se parashtrësit e pranuar përmes e-mail nuk pranohen, se e-mejl-ave të pranuar do t’u përgjigjen se është e nevojshme të paraqitet parashtrësja e cila duhet të jetë e nënshkruar dora vet. |

Njoftime për publikun e gjerë

Për aktivitetet e kryetarit dhe anëtarëve të KGJRM, mund të mësohet nga komunikatat të cilat publikohen në ueb faqe.

Kryetari i Këshillit Gjyqësor në njërën nga mbledhjet i njoftoi anëtarët për deklaratën e dhënë para një shtëpie televizive gjatë ditës së mëparshme, e cila sipas tij është nxjerrë nga konteksti. Media transmetoi se Këshilli Gjyqësor në mbledhje do ta shqyrtoj përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarëve lidhur me raportin e Prokurorisë Speciale Publike. Në sqarimin e dhënë të Kryetarit, ai konsideron se Këshilli, si organ, nuk ka kompetencë të shqyrtoj raporte të organeve të tjera, përfshirë edhe raportin e Prokurorisë Speciale Publike.

Kryetari i Këshillit Gjyqësor, i cili sipas detyrës zyrtare është edhe kryetar i Këshillit Buxhetor Gjyqësor, e informoi publikun me komunikatë në lidhje me reagimet e shfaqura në media për pagesën e shtesave të pagave për gjyqtarët.

Kryetari i Këshillit Gjyqësor të RM dhe i Këshillit Buxhetor Gjyqësor mbajti takim edhe me gazetarë dhe publikun e interesuar me rastin e vendimit të Këshillit Buxhetor Gjyqësor për sigurimin e mjeteve të dedikuara për akordim si dotacione të pagave të gjyqtarëve në RM që janë parashikuar me ligj.

Ai theksoi se këto mjete janë pjesë të buxhetit vjetor gjyqësor dhe se të njëjtat nuk janë rritje e pagës së gjyqtarëve prej 35 %, nuk paguhen çdo muaj dhe Këshilli Buxhetor Gjyqësor i siguron konform mundësisë themelore ligjore e cila është përcaktuar (e njëjta vlen dhe aplikohet vite me radhë në Prokurorinë Publike dhe në Prokurorinë Speciale Publike), ndërsa kryetarëve të gjykatave u është lënë të vendosin nëse këto mjete të siguruara do tua shpërndajnë gjyqtarëve. Deri më tani, praktika e këtillë e akordimit të dotacioneve në pagat e gjyqtarëve evitohej, meqë me Ligjin për shërbimin gjyqësor kjo mundësi për bashkëpunëtorët profesionistë në gjykatat e RM-së nuk është parashikuar siç është parashikuar për bashkëpunëtorët profesionistë në Prokurorinë Publike dhe në Prokurorinë Speciale Publike. Për këtë çështje Kryetari shumë herë ka biseduar me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave të RM.

Me rastin e dotacioneve të pagave për gjyqtarët ai theksoi se paraqitet një problem, gjyqtarët kanë kundërshtuar meqë janë vendosur në pozitë të pabarabartë me prokurorët, me ç'rast një gjyqtar në Gjykatën Themelore në Tetovë ka arritur të fitoj aktgjykim të shkallës së parë për pagesën e këtyre dotacioneve. Kjo paraqet rrezik për buxhetin gjyqësor nëse ky aktgjykim konfirmohet nga gjykata e shkallës së dytë, dhe i njëjti mund të shfrytëzohet si pilot aktgjykim dhe të shkaktoj një valë të padive nga ana e gjyqtarëve dhe seriozisht ta dëmtoj buxhetin gjyqësor.

Këshilli Buxhetor Gjyqësor miratoi edhe vendim për pagesën e kontributeve edhe për anëtarët e Këshillit Gjyqësor, gjë që shkaktoi reagime të bujshme në publik. Ministrja e Drejtësisë doli me komunikatë se një gjë e këtillë është e kundërligjshme dhe se do të ndërmerren masa përkatëse. Arsyetimi i këtij vendimi u shpjegua para mediave nga ana e kryetarit të Këshillit Gjyqësor duke iu përgjigjur pyetjeve të mediave. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Buxhetor Gjyqësor nuk doli me komunikatë zyrtare për arsyetimin e këtij vendimi. Më datë 30.01.2019 është caktuar mbledhja në të cilën në rend dite është paraparë miratimi i Rregullores për shtojcën e pagave, lartësinë e tyre dhe mënyrën e përcaktimit për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, gjyqtarët dhe shërbimit gjyqësor.

LLOGARIDHËNIA E KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2016 i cili iu dorëzua Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në korrik të vitit 2017, u shqyrtua në muajin shtator të vitit 2018 në Kuvendin e RM, ndërsa më datë 9.1.2019 nuk u miratua nga ana e Kuvendit të RM me 57 vota Kundër, një Për dhe një Abstenim.

Raporti për vitin 2017 edhe pse është dërguar në Kuvendin e RM sipas të njëjtit deputetët akoma nuk kanë votuar.

Këshilli Gjyqësor nuk doli me komunikatë për publikun në lidhje me mos-votimin e raportit për vitin 2016.

Raport i revizionit

Sipas Raportit përfundimtar për revizionin e kryer mbi raportet financiare dhe revizioni për harmonizimin për vitin 2017 të Këshillit Gjyqësor të RM, Enti Shtetëror i Revizionit ka konstatuar punë pozitive financiare, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Në raportin e revizionit theksohet se ekziston mosharmonizim të mjeteve të përcaktuara me ligj për pushtetin gjyqësor me ato të cilat pushteti gjyqësor i pranon nga Buxheti i RM. Pjesa më e madhe e mjeteve janë të dedikuara për paga dhe një pjesë e vogël për shpenzime kapitale dhe investime për zhvillimin e pushtetit gjyqësor.

EFEKTIVITETI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Zgjedhja e gjyqtarëve: Tetor 2018 - Janar 2019

| Gjykata | Kandidati i zgjedhur | Kandidatë të paraqitur | Numri rendor i rank listës përfundimtare të kandidatit të zgjedhur |
|--|--|--|--|
| Gjykata e Apelit Shkup për fushën penale | Lirie Elezi Ajrullau–gjyqtare në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup | 23 kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet në përputhje me ligjin . | 1 |
| Gjykata e Lartë Administrative | Subhi Jakupi-ish anëtar i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve | 29 kandidatë, nga të cilët dy kandidatë nuk i plotësojnë kushtet në përputhje me ligjin për stazhin e nevojshëm prej 8 vjetësh në punë juridike në organ shtetëror. Pesë nga kandidatët nuk janë paraqitur në testimin e caktuar për t’iu nënshtruar testit psikologjik dhe testit të integritetit. 22 kandidatët e tjerë i plotësonin kushtet në përputhje me ligjin. | 1 |
| Gjykata Administrative | Elizabeta Vaskova–Këshilltare shtetërore në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë | 60 kandidatë. Njëri nga aplikimet e paraqitura nuk është paraqitur në kohën e duhur, 9 (nëntë) aplikime janë me dokumentacion të pakompletuar, 2 (dy) kandidatë nuk i plotësojnë kushtet në përputhje me ligjin për stazhin e nevojshëm prej 5 vitesh në punë juridike në organ shtetëror. Shtatë kandidatë nuk janë paraqitur në testimin e caktuar për t’iu nënshtruar testit psikologjik dhe testit të integritetit, ndërsa një kandidat e ka tërhequr aplikimin. | 2 (nga rank lista përfundimtare e kandidatëve për zgjedhjen e 2 gjyqtarëve të Gjykatës Administrative – Maqedonase sipas përkatësisë etnike) |
| Gjykata Administrative | Imsale Hasani–bashkëpunëtore e re në Gjykatën Themelore Tetovë | 60 kandidatë. Njëri nga aplikimet e paraqitura nuk është paraqitur në kohën e duhur, 9 (nëntë) aplikime janë me dokumentacion të pakompletuar, 2 (dy) kandidatë nuk i plotësojnë kushtet në përputhje me ligjin për stazhin e nevojshëm prej 6 vitesh në punë juridike në organ shtetëror. Shtatë kandidatë nuk janë paraqitur në testimin e caktuar për t’iu nënshtruar testit psikologjik dhe testit të integritetit, ndërsa një kandidat e ka tërhequr aplikimin. | 9 (nga lista përfundimtare e kandidatëve – Pjesëtarë të bashkësive të cilat nuk janë shumicë në RM). |

Zgjedhja e gjyqtarëve: Tetor 2018 - Janar 2019

| Gjykata | Kandidati i zgjedhur | Kandidatë të paraqitur | Numri rendor i rank listës përfundimtare të kandidatit të zgjedhur |
|----------------------------|---|--|--|
| Gjykata e Apelit Shkup | Lidija Dimçevska-gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkup | 11 kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet në përputhje me ligjin. | 3 |
| Gjykata Themelore Krushevë | Lidija Andreska-gjyqtare në Gjykatës Themelore Krushevë | 1 kandidat i cili i plotëson kushtet | |
| Gjykata Themelore Berovë | Lenka Simevska – gjyqtare në Gjykatën Themelore Berovë | 1 kandidat i cili i plotëson kushtet | |
| Gjykata Themelore Dibër | Ilir Iseni – gjyqtar në Gjykatën Themelore Dibër | 3 (tre) kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet në përputhje me ligjin | 1 |

Për herë të parë në procedurën për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave të gjithë anëtarët e Këshillit Gjyqësor veç e veç i arsyetuan shkaqet të cilat janë bazë për votimin e tyre. Ky obligim i tyre rezultoi nga ndryshimet ligjore, ndërsa të njëjtin e praktikojnë vetëm për gjyqtarët të cilët janë zgjedhur për kryetarë të gjykatës ose për gjyqtarë në gjykatë më të lartë, por jo edhe për gjyqtarët të cilët nuk janë zgjedhur, ndërkaq patën numër më të lartë të pikëve nga gjyqtarët e zgjedhur.

Ekziston përmirësim sa i përket transparencës së mënyrës së zgjedhjes së gjyqtarëve me atë që gjatë kohës së mbledhjeve kandidatët japin arsye se pse për kandidatë të caktuar kanë votuar PRO, ndërsa nga ana tjetër vendimet për zgjedhjen e kryetarëve dhe gjyqtarëve publikohen në ueb faqen e Këshillit Gjyqësor dhe përmbajnë informacione për të gjithë kandidatët e paraqitur siç është: arsimit, vitet e stazhit, pikët nga notimi i rregullt dhe përkatësia etnike. Rezultatet e anketës anonime për opinionin e kandidatëve për gjyqtarë janë të aksesshme vetëm në vendimin e publikuar për zgjedhjen e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Shkup – fusha penale – pjesëtarë të bashkësive të cilat nuk janë shumicë në RM.

Nga ana tjetër, rezultatet e anketës anonime nuk kanë domethënie në krijimin e rank listës.

Vendimet për zgjedhje edhe pse përfshijnë të dhëna për të gjithë kandidatët, megjithatë nuk përmbajnë arsyetim se pse kandidati i caktuar është zgjedhur edhe pse nuk është i pari në listën e rankimit.

Zgjedhja e gjyqtarit në Gjykatën Supreme të RM në fushën penale u prolongua. Krahas rank listës së përcaktuar përfundimtare që më 30 tetor, në të cilën u vendos që votimi të bëhet në ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme, deri më tani mbledhja për votim nuk është caktuar.

Në janar të vitit 2019 u shpall konkurs për zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj në Gjykatën Administrative të RM. Me zgjedhjen e këtyre gjyqtarëve do të plotësohen të gjitha vendet vakante në Gjykatën Administrative. Veç tjerash, kjo gjykatë deri më tani është vlerësuar si gjykatë e azhurnuar.

Në Gjykatën Administrative për momentin mund të konkurrojnë edhe persona të cilët kanë më së paku pesë vjet stazh në punë juridike në organ shtetëror me rezultate të konfirmuara gjatë punës. Megjithatë, me ndryshimet e fundit ligjore, të cilat janë në procedurë miratimi në Kuvendin e RM, parashikohet që për gjyqtar

të Gjykatës Administrative të mund të zgjidhet vetëm personi i cili e ka kryer trajnimin fillestar për gjyqtar dhe prokuror publik ose i cili ka përvijë pune prej më së paku katër vjet stazh të pandërprerë të gjyqtarit si gjyqtar në gjykatë themelore deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje dhe i cili nga ana e organit kompetent është notuar me notë pozitive, në përputhje me ligjin dhe është në mesin e pesë kandidatëve të rankuar të parë në konkurs.

Me plotësimin e të gjitha vendeve në Gjykatën Administrative për momentin lind dyshimi për abuzimin e situatës në lidhje me atë që të plotësohen vendet e gjyqtarëve me persona jashtë gjyqësorit derisa nuk miratohen ndryshimet e fundit të cilat janë në procedurë kuvendore.

Së këtejmi, Gjykatave të Apelit si dhe Gjykatës Supreme vite me radhë nuk iu plotësohen vendet vakante të cilat duhet të plotësohen konform sistematizimit.

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të RM

Për herë të parë, pas rekomandimeve të Institutit për Drejtat e Njeriut, Këshilli Gjyqësor i RM e publikoi listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor. Kjo listë u publikua si pjesë e komunikatës për mbledhjen e mbajtur dhe jo si komunikatë e veçantë, me ç'rast do të sigurohej vizibilitet më i madh i kandidatëve.

Megjithatë, në të ardhmen nevojitet që përveç listës së kandidatëve me emra të publikohet edhe një biografi e shkurtër ose linku deri te biografitë ekzistuese të kandidatëve të publikuara në ueb faqet e gjykatave në mënyrë që të gjithë gjyqtarët të cilët votojnë në mënyrë të drejtpërdrejt për anëtarin e Këshillit të njoftohen me kandidatët.

Më datë 10.12.2018 **u realizua zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë, në të gjitha gjykatat** në territorin e Republikës së Maqedonisë ku votuan gjyqtarët e regjistruar në Listën emërore gjyqësore zgjedhore.

Për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë nga radha e gjyqtarëve **nga Gjykata Supreme** të Republikës së Maqedonisë u zgjodh:

- **Kiro Zdravev;**

Për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë nga radha e gjyqtarëve të juridiksionit të **Gjykatës së Apelit Shkup** dhe gjykatave administrative u zgjodh:

- **Gordana Spirevska;**

Për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë nga radha e gjyqtarëve të juridiksionit të **Gjykatës së Apelit Gostivar** u zgjodh:

- **Zoran Teofilovski;**

Për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë nga radha e gjyqtarëve të juridiksionit të **Gjykatës së Apelit Shtip** u zgjodh:

- **Loreta Gorgieva;**

Për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë nga radha e **gjyqtarëve pjesëtarë të të gjitha bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë** për gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë u zgjodh:

- **Mirsad Suroji**

Në këtë [link](#) është e aksesshme pasqyra **tabelore e votimit nëpër gjykata për secilin kandidat**

Këshilli Gjyqësor e miratoi Programin vjetor për punën e Këshillit me Plan Veprim për vitin 2019, që si detyrim ligjor është parashikuar në ndryshimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor.

U formua Qendra për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit, Analitikë dhe Statistikë, së këtejmi me vendim të Këshillit Gjyqësor janë sistematizuar tre të punësuar të Këshillit Gjyqësor në Qendër sepse Ministria e Financave nuk ka aprovuar mjete për punësimin e personelit përkatës edhe krahas obligimit ligjor dhe angazhimit për t'u formuar kjo Qendër si qëllim strategjik.

Përcaktimi i përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës

Këshilli diskutoi edhe për pikat e rendit të ditës të cilat ishin të mbyllura për publikun – për procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës. Për këto procedura të cilat janë të fshehta nuk ka komunikata të posaçme dhe nuk ka as vendime të publikuara për ndërprerjen ose përfundimin e procedurës nga ana e Këshillit Gjyqësor.

Parashtresa

| Tetor 2018 – Janar 2019 | |
|--|----|
| Numri i përgjithshëm i parashtresave të pranuar dhe shqyrtuara | 78 |

Институтот за човекови права изготви мобилна апликација за следење на работата на Судскиот совет. Апликацијата може да ја преземете БЕСПЛАТНО на Google Play Store и на Apple Store под името „Судски совет под лупа“. Тука ќе ги најдете сите тековни информации и квартални извештаи изработени во рамките на проектот „Зголемен јавен надзор врз работата на Судскиот совет на РМ“.

